

Video Skript për Familjet . "Përsëri në Shkollë"

Përshëndetje Familjarë të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. E Mërkura, 2 Shtator, është dita e parë e shkollës, dhe ne jemi të **gëzuar për zilen e parë Dixhitale** PHL. Ne mirëpresim të gjithë studentët tanë për një vit të ri mësimor të suksesshëm . Siç kam thënë edhe më parë, ky vit shkollor do të jetë ndryshe nga çdo vit tjetër.

Një gjë e re dhe e ndryshme është që të gjithë studentët nga Pre - K deri në klasën e 12-të do të fillojnë vitin shkollor në mësimin dixhital pesë ditë në javë me mësuesit nga shkolla e tyre e regjistruar. Pa dyshim për këtë, **ky do të jetë një vit i vërtetë shkollor**. Kështu që është **me rëndësi kritike** për **T E GJITHE** nxënësit që të fillojnë vitin e ri shkollor me pajisjet e tyre dixhitale **në kohë, çdo ditë ... duke filluar që ditën e parë**. Kjo do të thotë të përgatitesh para kohe duke e **ditur** orarin e shkollës së fëmijës suaj, **duke siguruar që** fëmija juaj të ketë një Chromebook që punon ose pajisje tjetër dixhitale për të përdorur çdo ditë DHE **duke u siguruar** që të keni akses në internet.

Përvoja dixhitale e të mësuarit për studentët do të duket dhe ndjehet ndryshe nga pranvera e kaluar. Bazuar në reagimet që na keni dhënë, ne po sigurohemi që studentët të kenë më shumë kohë për të punuar së

bashku, të përfshihen në mësim të bazuar në projekte, të aplikojnë studimet e tyre në klasë në përvojat e jetës reale dhe të bashkëveprojnë me mësuesit. Ne gjithashtu kemi siguruar trajnime shtesë për mësuesit tanë për të forcuar aftësinë e tyre për të ofruar udhëzime angazhuese dixhitale.

Edhe pse shkolla do të jetë plotësisht dixhitale, ne dëshirojmë të rivendosim një ndjenjë shumë të nevojshme të familjaritetit dhe rutinës për nxënësit tanë. Pra, përsëri, kjo fillon me hyrjen në çdo klasë, në kohë, çdo ditë ... njësoj siç do të prisnim që ata të paraqiteshin në klasat e tyre në ndërtesat e shkollës çdo ditë. Pjesëmarrja së bashku me vlerësimin , do të jetë një pjesë e rëndësishme e krijimit të mjediseve të të mësuarit , ku mësuesit dhe studentët mbajnë **lidhje të forta ditore** dhe studentët ndjehen të mbështetur dhe të angazhuar.

Ne e pranojmë që disa familje mund të kenë rrethana që e bëjnë pjesëmarrjen e përditshme të studentëve në internet të vështirë. Ju lutemi e dini që **ne e kuptojmë** ... dhe ne jemi këtu për të punuar me ju për të mbështetur suksesin e fëmijës suaj në shkollë. Nëse ka ndonjë pengesë në vijimin e shkollës së fëmijës suaj në shkollë, ju lutemi drejtohuni mësuesit të fëmijës suaj ose dërgoni me email në " Office of Attendance & Truancy" në: attendanceandtruancy@philasd.org për ndihmë.

Gjithashtu është e qartë se studentët dhe familjet tona kanë kaluar trauma të konsiderueshme për shkak të COVID-19 dhe të ndikimit racist në vazhdim, sistematik dhe pabarazitë. Pra, ne jemi duke punuar me partnerë lokalë të besuar dhe ekspertë kombëtarë për të filluar iniciativën "Healing Together" për studentët dhe personelin .

Si pjesë e kësaj përpjekjeje, të gjithë studentët do të jenë në gjendje të marrin pjesë në takime të komunitetit me mësuesit dhe bashkëmoshatarët e tyre dhe të përfshihen në aktivitete mësimore-emocionale dhe aktivitete për krijimin e marrëdhënieve gjatë gjithë ditës. Për shëmbull, mësuesit mund të futin ushtrime kuptimplote në klasat e tyre për t'i ndihmuar studentët të administrojnë dhe rregullojnë emocionet që mund të përjetojnë. Mësuesit dhe këshilltarët gjithashtu do të punojnë së bashku për të identifikuar studentët që kanë nevojë për ndihmë shtesë dhe t'i lidhin familjet me burime shtesë aty ku është e nevojshme. Një person për shërbimin e shëndetit dhe sjelljes gjithashtu do të caktohet në secilën shkollë për të ofruar mbështetje shtesë.

Ju mund të gjeni më shumë informacione shkollore, udhëzime dhe burime në: philasd.org/backtoschool. Edhe një herë, jemi vërtet të entuziazmuar të mirëpresim secilin prej jush në këtë vit të ri shkollor.